

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **30.07.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-547/13 për z.Besnik Vasolli – Këshilltar i Jashtëm (Koordinator teknik) në Ministrinë e Integrimeve Evropiane (MIE), dhe njëkohësisht Kordinatoi i Projekteve në GIZ (Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit GmbH), sepse nuk ka pasur prova të mjaftueshme që flasin për situatë të konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-547-13, për zyrtarin e lartë, z. Besnik Vasolli – Këshilltar i Jashtëm (Koordinator teknik) në Ministrinë e Integrimeve Evropiane (MIE), dhe njëkohësisht Kordinatoi i Projekteve në GIZ (Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit GmbH), është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-547/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, z. Vasolli së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-1294/13) pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me arsyen pse është ftuar në takim dhe nga ai është kërkuar sqarim për situatën në të cilën ndodhet, në mënyrë që të parandalohet ose të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit, nese ajo ekziston.

Zyrtari i lartë, z.Vasolli është deklaruar se është i gatshëm të bashkëpunoj me zyrtaret e Agjencisë (AKK) për sqarim të kësaj situatë. Vasolli ka deklaruar se sqarimin e situatës “konflikt interesi” e ka bërë me njerëz tjerë edhe kur e ka marr këtë angazhim shtese (part-time) në MIE, duke shqyrtuar në hollësi mundësinë e shfaqjes së konfliktit të interesit.

Më tutje ztr.Vasolli ka deklaruar se ka qenë i bindur atëherë (me marrjen e detyrës) e është i bindur edhe tash se nuk ka konflikt interesi, sepse ky angazhim është bërë me pajtimin reciprok

të dy institucioneve përkatëse dhe pas një kërkesë me shkrim të Ministrisë së Integrimi Evropiane (znj.Çitaku) drejtuar GIZ-it, për të mundësuar angazhimin e tij si Koordinator teknik i Projektit për liberalizimin e vizave, apo ndryshe i quajtur edhe si Këshilltar i Jashtëm i Ministres, Pastaj me lejen e GIZ-it, për të cilin ztr.Vasolli punon me kontratë të plotë që nga 1 gusht 2011, GIZ-i e ka lejuar një angazhim të tillë, sepse kjo për ta nuk paraqet konflikti të interesave.

Pas këtij takimi, kemi kërkuar nga ztr. Vasolli të na i dërgon me shkrim dokumentet e komunikimit ndërmjet këtyre dy institucioneve. Ztr. Vasolli këtë e ka bërë, dhe bashkë me një shkresë përcjellëse të tij, na i ka dërguar shkresën e Ministrisë së Integrimi Evropiane (01-2416-1-2012) në të cilën Ministria Çitaku i ka kërkuar GIZ-it leje që ztr.Vasolli ta angazhoj me orar të pjesshëm (part-time), si këshilltar i jashtëm në lidhje me Procesin e liberalizimit të vizave.

Këtë kërkesë, siç na ka njoftuar ztr. Wolf Michael Mors-Udhëheqës i ekipit të GIZ-it për mbështetje të procesit të integritit të Kosovës në shkresën zyrtare (DPK/DPKI-03-1869.13), e ka aprovuar Drejtori i GIZ-it për Kosovë.

Pos kësaj, ztr. Wolf në shkresën e tij (DPK/DPKI-03-1869.13), lidhur me këtë rast ka njoftuar në detaje se cili është roli i ztr.Vasolli te GIZ-ii si dhe ka konfirmuar se ata janë në dijeni se ztr.Vasolli ushtron edhe rolin e Koordinatorit teknik te Ministria Çitaku në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, për çka edhe vet "GIZ" kishte dhënë pëlqimin e vet paraprak.

Po ashtu ztr. Vasolli ka deklaruar se për punën e Këshilltarit të jashtëm ose Koordinatorit teknik në procesin e Liberalizimit të vizave në Ministrinë e Integrimi Evropiane nuk merr kurrfarë kompensimi. Ztr.Vasolli punë primare e konsideron punën te "GIZ", ndërsa angazhimi në MIE është angazhim në cilësinë e Këshilltarit të jashtëm që e kryen pa pagesë. Ai gjithashtu ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj roli vendimarrës në këtë punë, as në njërin e as në institucion tjetër.

Këto pohime të Ztr.Vasollit na janë konfirmuar edhe me shkrim nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integrimi Evropiane (ztr.Demush Shasha) në shkresën zyrtare (02-1407-1-2013).

Realizimi i Projektit të "GIZ"-it me "MIE" nuk varet nga roli i ztr. Vasolli, sese ai është një projekt për mbështetje që do të zgjas gjatë vite.

Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) në nenin 8 ka paraparë se cilat janë detyrimet e Zyrtarit të lartë për të parandaluar konfliktin e interesit.

Në këtë kuadër paragrafët e këtij neni (1, 2, 3, dhe 5) obligojnë në radhë të parë zyrtarin e lartë, pastaj institucionin ku zyrtari i lartë ushtron funksionin e tij publik dhe krejt në fund edhe Agjencinë kundër Korrupsionit për të sqaruar dhe dhënë vlersimin për situata të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Po ashtu Ligji të cilit po i referohemi në Nenin 13 ka rregulluar situatën kur Zyrtari i Lartë duhet të bëjë deklarin rast për rast të interesave të tija private lidhur me një vendimarrje të caktuar që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit (Neni 13, paragrafi 1).

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera nxjerrim këtë:


Andaj , duke u bazuar në faktet dhe gjendjen reale, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /



Agjencia Kundër Korrupsionit / Agencia protiv korupcije / Anti Corruption Agency

www.akk-rks.org ,